



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Datë: 11.07.2025
Numër Protokolli: 4791/2025

A.nr.875/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.875/2025, të datës 13.05.2025, të parashtuar nga ankuesi M.B, kundër organit të punësimit: Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim më datë 11.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.875/2025 e datës 13.05.2025, e parashtuar nga ankuesi, M.B.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, M.B (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 13.05.2025, ka parashtuar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit, në raport me kërkesën e datës 01.04.2025, për kompensimin e orëve të kujdestarisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjilanit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 10.06.2025, ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen përkatëse ankimore.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtuara nga ankuesi, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Komunën e Gjilanit, dhe se i njëjti sipas Akt emërimit me numër protokolli 02-16-14942, të datës 08.02.2012, është i emëruar në pozitën e punës Shef i Shërbimeve Sociale, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Çështje Sociale-QPS.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesi më datë 01.04.2025, ka parashtruar kërkesë pranë Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, lidhur me kompensimin e orëve të kujdestarisë, jashtë orarit të rregullt të punës.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi pretendimin ankimor që ti bëhet kompensimi nga Komuna e Gjilanit, për orët e kujdestarisë jashtë orarit të rregullt të punës. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të detyroj organin e punësimit për shqyrtimin e kërkesës së parashtruar.

Kolegji i Këshillit në kuptim të pranushmerisë së ankesës së ankuesit iu referua Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më konkret nenit 98 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj,* si dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: *“1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ...”* e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konstaton se ankesa e parashtruar është e paraafatshme, pasi që ankuesi ende pa kaluar afati ligjor për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar sipas kërkesës së datës 01.04.2025 dhe rrjedhimisht ende pa u përmbushur kriteri kohor lidhur me heshtjen administrative parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj, mbi këtë bazë, Kolegji vlerëson se ankesa e ankuesit si në pikën I të dispozitivit është pa pranueshme në kuptim të nenit 129, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.7, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.875/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, M.B;
- Organit të punësimit: Komunës së Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.